

Komuna e Deçanit: problemet kryesore dhe trendët buxhetor

Hyrje

1. Komuna e Deçanit udhëhiqet nga z. Rasim Selmanaj i cili vjen nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Ky subjekt politik e udhëheq këtë komunë nga viti 2002.
2. Komuna e Deçanit gjendet në pjesën perëndimore të Kosovës, me një sipërfaqe prej 372 km². Kjo komunë ka gjithsej 36 fshatra. Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, Komuna e Deçanit ka 40.019 banorë.¹
3. Kuvendi Komunal i Deçanit ka 27 këshilltarë: 16 këshilltarë nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), pesë këshilltarë nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dy nga Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD), aq sa ka edhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dhe me nga një këshilltar kanë Aleanca Kosova e Re (AKR) dhe Partia Socialdemokrate (PSD).
4. Sipas një hulumtimi të Institutit GAP, i realizuar në vitin 2009, problemet më të mëdha me të cilat janë përballuar qytetarët e Deçanit kanë qenë mungesa e kanalizimit, prezenca e mbeturinave, mungesa e rrjetit të ujësjellësit, mos funksionalizimi i pushimores së fëmijëve, prerja e pyjeve, kundërmimi i ujërave të zeza, komunikacioni, mungesa e parkingjeve, humbja e tokës bujqësore, si dhe mos zhvillimi ekonomik.²
5. Në hulumtimin e zhvilluar nga UNDP i përmbledhur në raportin “Mozaiku i Kosovës 2012”, 71% e banorëve të Deçanit besojnë se autoritetet e tyre lokale kanë kapacitet për të zgjidhur problemet në komunën e tyre. Përqindja e atyre që besojnë se vetëm pushteti qendror mund të zgjidhë këto probleme është 14%.³

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Burimi: http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf

² Instituti GAP. Raporti për Komunën e Deçanit. Fq 7. 2009. Burimi: http://www.institutigap.org/documents/82819_Decani-raporti%20komunal%20final.pdf

³ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 27. Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

Problemet kryesore në Komunën e Deçanit 2013

- 1. Mbeturinat dhe deponitë ilegale.** Në Deçan mbeturinat menaxhohen nga kompania rajonale “Higjiena”. Si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale vërehet papastërti dhe grumbuj mbeturinash. Kësisoj është gjendja prapa ndërtesave në rrugën kryesore “Shkëlzen Haradinaj” si dhe përgjatë rrugës magjistrale Deçan – Gjakovë. Mbeturinat hasen të derdhura edhe përgjatë vijës së shtratit të lumit “Lumëbardh”. Mbeturina të hedhura gjenden edhe në vendin e quajtur “Podi i Gështenjave”. Mbeturina në këtë vend shpeshherë u vihet zjarri duke shkaktuar ndotje të ambientit dhe shtëpive përreth. Zona e quajtur “Podi i Gështenjave” është atraksion i veçantë natyror i Deçanit dhe dhjetëra familje nga kjo komunë i sigurojnë të ardhurat e tyre nga mbledhja dhe shitja e gështenjave që janë të shumta në këtë zonë. Shumë mbeturina gjenden edhe në oborrit e kompanisë “Higjiena” e cila është përgjegjëse për pastrimin e qytetit. Nga oborri i kësaj ndërmarrje era shpërndan mbeturinat në lokacionet tjera. Në territorin e Komunës së Deçanit besohet të jenë mbi 80 deponi mbeturinash.⁴ Sipas rezultateve të UNDP-së, 30% e deçanasve konsiderojnë qytetin e tyre shumë të ndotur, ndërsa 29% të tillë e konsiderojnë lagjen e tyre.⁵
- 2. Prerja e pyjeve.** Njëri ndër problemet më të theksuara në Komunën e Deçanit është shkatërrimi i vazhdueshëm dhe sistematik i pyjeve nga prerja ilegale e tyre. Nga prerja nuk janë kursyer as pishat e mbjella dekada me herët. Fshatrat që konsiderohen me të prekura nga kjo dukuri janë malet në Beleg, Baballoqit, Isnic, Prilepit, Rrznqi, Voksh dhe Dashinoc. Në janar të vitit të kaluar, komuna ka marr vendim për aplikimin e të ashtuquajturit ‘Moratorium’, i cili ka paraparë ndërprerjen e prerjeve të pyjeve për pesë vitet e ardhshme, por nga zhvillimet në terren, tregohet se kjo masë nuk është respektuar. Prerja e pyjeve ka vazhduar edhe pas marrjes së atij vendimi.⁶
- 3. Pallati i Kulturës “Jusuf Gërvalla”.** Mungesa e pastërtisë, dyert dhe dritaret e dëmtuara, mungesa e inventarit, dyshemetë e shkatërruara, mungesa e gëlqerosjes së brendshme dhe të jashtme, mos funksionimi elektrik në pjesën më të madhe të objektit, janë vetëm disa nga gjërat që e karakterizojnë objektin e

⁴ Gazeta JNK. Deçani me 80 deponi mbeturinash. Autor, Kreshnik Gashi. 17 shtator 2012. Burimi: <http://gazetajnk.com/?cid=1,978,2674>

⁵ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 25. Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

⁶ Komuna e Deçanit. Faqja zyrtare. 18 janar 2012. Vendimi për prerjen e pyjeve, pasqyrimi në rubrikën e lajmeve. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/decan/Lajmet/Kuvendi-shpall-moratorium-ne-mbrojte-te-pyjeve.aspx>

pallatit të kulturës i cili është krejt afër me objektin e Komunës së Deçanit. Mbi 80% e hapësirës së brendshme është e papërdorshme, ndërsa pjesa tjetër përdoret nga bizneset private për ushtrimin e veprimtarive tregtare e komerciale. Objekti i kulturës nuk shfrytëzohet për asnjë veprimtari kulturore, përjashtimisht ndonjë manifestimi nga familjarët e dëshmorëve.

4. Mungesa e kanalizimit. Problem tjetër që i preokupon banorët e Deçanit është mungesa e kanalizimeve dhe mosfunksionimi i tyre në disa lokalitete. Në qendër të qytetit, gjatë të reshurave, lagjet e urbane vërshojnë nga pamundësia e absorbimit të ujit nga gypat e kanalizimit. Në fshatrat e rajonit të Vokshit, rrjeti i kanalizimit është shpërndarë, por kanalizimi kryesisht nuk funksionon dhe kundërmon. Një problem tjetër është se në mungesë të sistemit të kanalizimit, ujërat e zeza po derdhen në lumenj dhe toka bujqësore duke shkaktuar ndotje dhe degradim si në fshatrat Isnic, Strelc i Epërm, Strelc i Poshtëm, Beleg etj. Sipas hulumtimit të opinionit të qytetarëve të Deçanit nga organizata DEMI/USAID në vitin 2012, vetëm 48% e deçanasve janë shprehur të kënaqur me sistemin e kanalizimit në komunën dhe vendbanimin e tyre.⁷

5. Reduktimet e ujit të pijes. Edhe përkundër që Komuna e Deçanit konsiderohet si njëra ndër komunat me burime të shumta të ujit, reduktimet e ujit të pijes në zonat urbane, veçmas gjatë sezonit të verës, shkojnë deri në 10 orë në ditë.⁸ Reduktimet janë të theksuara edhe në të gjitha fshatrat e kësaj komune si në fshatin Drenoc, Strelc, Baballoq, Beleg, Dobovik, Gramaçel, Papiq, Prilep, etj. Sipas raportit të UNDP-së, 5% e deçanasve kanë pasur ndërprerje të furnizimit me ujë për 1 deri në 4 orë në ditë, 7% për 5 deri në 10 orë në ditë, kurse 4% kanë përvojë me ndërprerje më të gjata se 11 orë në ditë dhe 10% kanë thënë se shtypja e ujit është shumë e ulët për shfrytëzim shtëpiak.⁹

⁷ Programi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim (USAID). Raporti i anketimit mbi kënaqshme rinë e qytetarëve me shërbimet komunale. Fq 21. Burimi: http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen_Satisfaction_Report-Shqip.pdf

⁸ Gazeta "Koha Ditore". 22.07.2012. Deçani po vuan nga mungesa e ujit të pijes. Burimi: <http://www.kohaditore.com/?page=1,31,108387>

⁹ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. "Mozaiku i Kosovës". 2012. Fq 24. Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216825.pdf

Gjërat pozitive të cilat duhet ruajtur

- 1. Ruajtja e burimeve natyrore.** Deçani njihet për nga bukuritë natyrore si Gryka e Deçanit, Bjeshka e Belegut por edhe nga trashëgimitë kulturore ku përfshihen shumë monumente kulturore, historike dhe arkeologjike. Andaj ruajtja e kësaj trashëgimie paraqitet si prioritet nga qytetarët për zhvillim të turizmit në këtë rajon.
- 2. Festivali “Eshka e ndezur mbi Shkëlzen”.** Ky festival tradicionalisht festohet në Deçan që disa vite me radhë dhe i kushtohet rapsodëve Dervish Shaqa e Demush Neziri. Bashkëbiseduesit kanë kërkuar nga autoritetet e ardhshme që festivaleve të tilla t’u ofrohet përkrahje më e madhe dhe të përcjellen me promovim, me qëllim që ky festival të shndërrohet në festivalin mbarëkombëtar për këngët rapsodike.


Trendet Buxhetore në Komunën e Deçanit

Komuna e Deçanit në vitin 2013 ka planifikuar 6.4 milion euro buxhet. Krahasuar me vitin 2010, kjo komunë ka 664 mijë euro (11%) buxhet më shumë. Të hyrat vetanake të kësaj komune në vitin 2012 kanë qenë 733 mijë euro, apo 94 mijë euro më pak se vitin paraprak. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm¹⁰ ka rekomanduar: 1) që komuna duhet të vendosë një kontroll automatik të faturimit për të gjitha llojet e taksave; 2) të ndërmerren masa që të rritet mbledhja e të hyrave nga taksat e ndryshme dhe; 3) duhet të kryhen barazimet ndërmjet Zyrtarit të të Hyrave Vetanake dhe departamenteve operationale. Në bazë të përgjigjes së Kuvendit Komunal të Komunës së Deçanit, 50% apo 3.319 nga 6.638 prona të regjistruara nuk paguajnë tatim. Ndërsa 3-5% apo 331 prona nuk janë të regjistruara.¹¹

¹⁰ ZAP, Raporti i Auditimi mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Deçanit Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 06 Gusht 2013 http://oag-rks.org/repository/docs/Decan_Report_Alb_25.6_159328.pdf

¹¹ Përgjigje në Kërkesën e Institutit GAP, 6 Shtator 2013


Figura 1. Buxheti i Komunës së Deçanit 2013



Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?decan/2013#/~/~decan>

Në bazë të grafikonit rreth ndarjeve buxhetore, shohim se komuna e Deçanit pritet të ketë një rënie të shpenzimeve kapitale prej 677 mijë euro (33%) në vitin 2013. Një gjë tjetër që bie në pah është se shpenzimet e “mallrave dhe shërbimeve” kanë pasur një rritje graduale gjatë këtyre katër viteve. Kur jemi tek shpenzimet, Zyra e Auditorit në vitin 2012 ka gjetur 15 raste të vonimit të punëve në këtë komunë.

Figura 2. Trendet e ndarjeve buxhetore 2010-2013



Komuna e Deçanit planifikon një rritje graduale të të hyrave në vitet në vazhdim. Në vitin 2016 kjo komunë vlerëson se do të ketë rritje të buxhetit për 600 mijë euro krahasuar me vitin e tanishëm. Kjo rritje vlerësohet të financohet pothuajse në mënyrë të barabartë nga të hyrat vetanake dhe granti qeveritar.

Tabela 1: Planifikimi i të hyrave për komuna 2014-2016

Të hyrat	2014	2015	2016
Të hyrat totale	6.635.487	6.831.704	6.987.008
Të hyrat vetanake	630.000	648.900	661.878
Grantet	6.005.487	6.182.804	6.325.130

Metodologjia e hartimit të raportit

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe monitorimin e fushatave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulumtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Deçanit është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj. Të gjeturat e GAP janë mbështetur me të dhënat kuantitative të siguruara përmes anketës së zhvilluar nga ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012).



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.